



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF LIPJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Prilijeno: 16.05. 2024		
Mjësia Jednic:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-020/01-	24180	

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 1 e datës 12 .01.2012, Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014, Ligjit Nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022, Vendimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 5975/23 i datës 12.10.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

I. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e banesore, në këtë përbërje: (në vazhdim të tekstit Komisioni)

1. Lumnije Ejupi , Kryesuese e Komisionit
2. Ramadan Hoxha, anëtar i Komisionit
3. Shahadije Ibrahim, anëtare e Komisionit

II. Komisioni, për zbatimin e dispozitave të Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 12 .01.2012 dhe dispozitave të Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 , Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 si dhe Vendimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 5975/23 i datës 12.10.2023 , autorizohet si vijon :

1. Kompletion shënimeve të kërkuara me Ligjin e cekur për banesat në pronësi të Komunës të cilat ende nuk janë blerë nga bartësit e të drejtës banesore.

2.Njofton bartësit e së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzuesit e banesës për të drejtën për blerjen e banesës dhe dokumentacionin i cili duhet t'i bashkëngjitet kërkesës në pajtim me Ligjin.

3.Shqyrton kërkesat e bartësve të së drejtës banesore për banesat të cilat dhënës i banesave është Komuna si dhe për banesat për të cilat do të vërtetohet paraprakisht se nuk iu dihet kush do të jetë shitësi konform dispozitave të nenit 10 të Ligjit bazik.

4.Në pajtim me Ligjin, me dëshmi përkatëse vërteton se a është parashtruesi i kërkesës në grupin e personave që e kanë të drejtën për blerjen e banesës.

5.Në rast të kërkesave të paprecizuara dhe të dokumentacionit të pakompletuar s kërkon nga parashtruesi i kërkesës precizimin e kërkesës dhe kompletimin e dokumentacionit.

6.Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nxjerr Vendimin përkatës dhe lidhur me kërkesat e aprovuara përgatit për nënshkrim Kontratën e shitblerjes në pajtim me Ligjin.

7. Gjatë gjithë punës së tij, Komisioni është i obliguar t'i përmbahet procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 , Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 si dhe Vendimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 5975/23 i datës 12.10.2023.

III. Punët administrative – teknike për Komisionin i kryen Sektori pronëso-ro-juridik, ndërsa për kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet e blerjes, Komisionit në kalkulimin e çmimit të shitjes do t'i ndihmojë Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore 1Nr.020/04-21636 i datës 28.06.2022.

V. Me Vendim të njoftohen Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 01-020/01-24180
Lipjan, më 16.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive) që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-18472 të datës 08.04.2024, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Tramor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Erolind Bytyqi, nga OJQ-të, anëtar
5. Kamer Podrimqaku, nga shoqëria civili në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar dhe
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive) për vitin 2024 që kanë aplikuar konform thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-18472 të datës 08.04.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-24470
Lipjan, më 17.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
SKUPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110/78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E RAPORTEVE PËR LEJE MJEDISORE KOMUNALE

I. Me këtë Vendim themelohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e raporteve për Leje Mjedisore Komunale (LMK) ,në përbërje si vijon:

1. Jetmir Bytyqi, DPUMM Kryesues
2. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
3. Jalldyze Kallaba, DPUMM, anëtare

II. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni është i obliguar që të shqyrtoj të gjitha kërkesat për LMK në përputhje me nenin 32 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr, 01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale.

Pas shqyrtimit të Raportit, Komisioni jep opinion të shkruar lidhur me miratimin apo refuzimin e Lejes Mjedisore Komunale. Në rastet kur Raporti për LMK përmban mangësi jo esenciale atëherë Komisioni kërkon nga parashtruesi i kërkesës që brenda një afati të caktuar të menjanoj ato mangësi.

Komisioni ia paraqet në formë të shkruar opinionin për LMK Drejtorit të DPUMM dhe mbi këtë bazë lëshohet vendimi për miratim apo refuzim të LMK.

Para se të merret Vendimi për LMK parashtruesi i kërkesës duhet të paguaj tarifën e përcaktuar me nenin 15 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr,01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale.

Dokumentacioni i prezentuar nga palët për LMK përgaditet nga DPUMM dhe i dorëzohet Komisionit për shqyrtim ndërsa mbajtja e procesverbaleve të Komisionit,

përgaditja e raporteve dhe punët tjera administrative –juridike kryhen nga vet Komisioni.

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe zbatohet deri në një vendim tjetër.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për themelimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e raporteve për leje mjedisore komunale Nr.01-020/04-46081 i datës 25.08.2023.

Me këtë Vendim njoftohen:

Të emëruarit në Komisionin e caktuar;
DPUMM

01 Nr. 20/01-21651
Lipjan, më 02.05.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – PLANI DHE STRATEGJIA I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E LIPJANIT 2024-2027

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft - Plani dhe Strategjia i veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024-2027.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Plani dhe Strategjia i veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024-2027 ose në email adresën shkelzen.hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 15.06.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 115/01-26927
Lipjan, më 31.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA

O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- AKCIONI PLAN U STRATEGJIA ZA LICA SA OGRANIČENIM SPOSOBNOSTIMA U OPŠTINI LIPJAN 2024-2027

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- akcioni Plan u Strategjia za lica sa ograničenim sposobnostima u Opštini Lipjan 2024-2027.

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt- akcioni Plan u Strategjia za lica sa ograničenim sposobnostima u Opštini Lipjan 2024-2027 na email adresu: shkelzen.hajdini@rks-gov.net naj kasnije do 15.06.2024.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 115/01-26927
Lipljan, 31.05.2024

PREDSEDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,160.00€**, (gjashtëmijë e njëqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-21664 e datës 02.05.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 22 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin prill të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $22 \times 280 = 6,160.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-21664
Lipjan, më 02.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 par. 9 të Rregullores MF –Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400/01-21908 i datës 03.05.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR TJETËRSIMIN-ASGJËSIMIN E OBJEKTEVE TË VJETRA NË PRONËSI TË
KOMUNËS

Neni 1

TË TJETËRSOHEN –ASGJËSOHEN , objektet e vjetra në pronësi komunale në bazë të Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400/01-21908 i datës 03.05.2024, me shënimet si vijon:

1. 2007000000002995, SHF “ Idriz Ajeti” Resinocv (emërtimi i tanishëm “Vezir Kolshi”),
2. 2007000000002996, SHF “Jeronim De Rada” Magurë (emërtimi i tanishëm “Haradin Bajrami”.
3. 2013000000000757 – Objekt-konstruksioni i shtëpisë së bioenergjisë – dhoma me bojler
4. 2013000000000758 – Objekt – konstruksioni i shtëpisë eksperimentale –depozo në shtëpinë eksperimentale (aneks)
5. 2013000000000760 – Ndërtimi (Objekti) i punëtorisë për energjinë alternative
6. 2013000000000763 – Objekti për shtëpinë e vajit
7. 2013000000000764 – Ndërtimi i oxhakut për bojler ngrohës
8. 2013000000000765 – Ndërtimi i konstruksionit për dru-ruajtja e druve

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr. 400/01-21908
Lipjan, më 13.05.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e **Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026** të QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu në Lipjan, në përbërje si vijon:

1. Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kryesues,
2. Dr. Agim Krasniqi, Drejtor i QKMF-së, zëvendës kryesues,
3. Dr. Merita Bytyqi, anëtare,
4. Dr. Violeta Bunjaku, anëtare,
5. Dr. Luftim Bresa, anëtar,
6. Dr. Haxhi Bytyqi, anëtar,
7. Dr. Avdi Murati, anëtar,
8. Dr. Naim Avdija, anëtar,
9. Dr. Izer Sinani, anëtar ,
10. Dr. Mirëjeta Cakolli Bajçinca, anëtare,
11. Dr. Nexhmedin Lekiqi, anëtar,
12. Dr. Gazmend Qerkini, anëtar,
13. Dr. Egzona Bytyqi, anëtare,
14. Dr. Berat Dodaj, anëtar,
15. Dr. Fitim Shala, anëtar,
16. Albert Mustafa, anëtar,
17. Fahrije Gashi, anëtare ,
18. Luljeta Reqica, anëtare,
19. Kimete Retkoceri, anëtare,
20. Ganimete Zejnullahu, anëtare,
21. Shefki Bytyqi, anëtar,
22. Shemsije Jezerci, anëtare,
23. Naim Rashiti, anëtar,
24. Afrim Mena, Handikos, anëtar dhe
25. Alush Bikliqi, Këshilli i Pacientëve, anëtar.

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin e Planit të Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026 për QKMF Dr. Mehdi Zejnullahu duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi më së largu deri me datën 28.06.2024.

2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues dhe Zyrtarja për Konsultime me Publikun.

INr. 1-500/01-22032

Lipjan, më 03.05.2024

Kryetari i Komunës
Imri Ahmeti

